



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 53, datë 11.02.2020

**PËR PLOTËSIMIN E 1 (NJË) POZICIONI PRANË SHKOLLËS SË  
MAGJISTRATURËS PËRMES PROCEDURËS SË KOMANDIMIT TË  
PROKURORËVE**

Mbështetur në nenin 53, nenin 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 176/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”,i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 1 (një) pozicioni pranë Shkollës së Magjistraturës përmes procedurës së komandimit të prokurorëve, konkretisht për pozicionin e pedagogut të brendshëm.
2. Afati i komandimit do të jetë 3 (tre) vjet.
3. Ftohen të gjithë prokurorët e Republikës së Shqipërisë që nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar dhe që nuk janë të komanduar në një pozicion tjetër që të shprehin interesin për t’u komanduar.
4. Shprehja e interesit duhet të bëhet jo më vonë se 2 (dy) javë nga Njoftimi për shprehjen e interesit në faqen zyrtare të Këshillit dhe të dorëzohet në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa”, nr.1 Tiranë**. Mbi zarf duhet të shënohet: “Shprehje Interesi për Komandim pranë Shkollës së Magjistraturës”. Shprehja e interesit duhet të përmbajë: Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4) si dhe një CV e përditësuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

